



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3 lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Dardaniaa" Sh.P.K. të datës 19.11.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës në Glllogovicë - Gregjenik" me nr. të prokurimit 616-24-11788-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Dardaniaa" Sh.P.K. të datës 19.11.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës në Glllogovicë - Gregjenik" me nr. të prokurimit 616-24-11788-5-2-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Dardaniaa" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.11.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës në Glllogovicë - Gregjenik" me nr. të prokurimit 616-24-11788-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

- P.1.** - Parashtruesi pretendon që duhet të largohen kërkesat për referenca të noterizuara si dhe kërkesa për kontrata të përfunduara.
- P.2.** - Parashtruesi pretendon që duhet të largohen kërkesa për ISO 28001:2017.
- P.3.** - Parashtruesi pretendon që duhet të ndryshohet kërkesa për buldozer 25-26 në buldozer 23 ton ose 30 ton.
- P.4.** - Parashtruesi pretendon që duhet të largohen kërkesat për eskavator dhe kërkon që në vend të tyre të lejohet përdorimi i vetëm 1 eskavatori me zinxhir.
- P.5.** - Parashtruesi pretendon që duhet të largohet kërkesa për lugë hidraulike ripper 2.5 deri 3 ton.
- P.6.** - Parashtruesi pretendon që duhet të largohet kërkesa për freze që montohet në bager deri në 500 kg.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësi kërkuese.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 1, kërkesat për kontrata të përfunduara në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë si dhe referencat që dëshmojnë përfundimin e këtyre kontratave bëjnë pjesë në mesin e kërkesave me bazikë për secilin aktivitet të prokurimit. Në rastin konkret këto kërkesa përveç që janë themelore janë edhe të domosdoshme për të vlerësuar kapacitetin teknik dhe profesional të ofertave që do të dorëzohen. Kërkesat e formuluar si të filla janë në përputhje të plotë me nenin 69 të LPP. Prandaj ky pretendim është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin ankimor nr. 2, kërkesa në fjalë shërben si kërkesë e domosdoshme për të konfirmuar standardin e nevojshëm të cilësisë që duhet të manifestohet nga ofertat që do të dorëzohen. Kërkesa si e tillë është në përputhje të plotë me nenin 70 të LPP. Prandaj edhe ky pretendim është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimet ankimore nr. 3, 4, 5 dhe 6 duhet theksuar që këto pretendime i referohen pajisjeve të kërkuara përmes dosjes së tenderit. Fillimisht duhet sqaruar se të gjitha pajisjet pa përjashtim janë në përputhje të plotë jo vetëm me qëllimin e aktivitetit të prokurimit por edhe me natyrën dhe kompleksitetin e projektit që synohet të ekzekutohet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Pajisjet mbeten të pandryshuara dhe vlen të shtohet që të njëjtat janë në përputhje të plotë me parimet themelore të prokurimit publik siç janë neni 6 i LPP - parimi i efikasitetit dhe efektivitetit si dhe neni 7 - parimi i mosdiskriminimit dhe mosfavorizimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 20.11.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.